



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

Data: 31.1.2025

Nr: 53

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË SARANDË, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 31.1.2025 unë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

**SUBJEKT:** Bashkia Sarandë

**OBJEKT:** Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Sarandë për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencie, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**KONSTATOJ:**

Gjatë periudhës 19- 25 janar 2025, Bashkia Sarandë ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve (NRI), 2 (dy) veprimtari përtej afatit ligjor të përcaktuar në nenin 92, pika 2 të Kodit Zgjedhor, si vijon.

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 10.00, Njësia Administrative Sarandë, me tematikë “Inspektim”, “Infrastrukturë”, “Kryetari i Bashkisë Sarandë z. Oltion Caci së bashku me Drejtorin e Shërbimeve z. Joli Dine dhe specialist të kësaj drejtorie do të inspektojnë rrugë të ndryshme të qytetit për vendosjen e sinjalistikës horizontale dhe vertikale”.

Data: 31.1.2025 Nr: 53  
Ora: 12:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Sarandë, për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

- Në datën 20.1.2025 ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 24.1.2025, ora 12.00, Njësia Administrative Sarandë, me tematikë “Inspektim”, “Infrastrukturë”, “Kryetari i Bashkisë Sarandë z. Oltion Caci së bashku me Drejtorin e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit z. Zenel Bajrami, Drejtorin e shërbimeve z. Joli Dine do të inspektojnë rikonstruksionin e rrugës "Pandeli Bocari" Sarandë.

Nëpërmjet email-it, administrata e KQZ-së i ka kërkuar Bashkisë Sarandë një informacion sqarues në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes, ose t'i paraqesë ato në seancën publike të datës 31.1.2025, ora 12:00.

Pas njoftimit të kryer, personi përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike të Bashkisë Sarandë ka dërguar pretendimet, duke sqaruar se: “Datat e veprimtarive të raportuara janë vendosur gabimisht për t'u zhvilluar në datën 24.01.2025. Dy inspektimet e raportuara janë zhvilluar në datë 27.01.2025”.

Referuar pretendimeve të dhëna dhe hetimeve të kryera nga ana e KQZ, vlerësohet se është kryer një gabim gjatë hedhjes së të dhënave në ndërfaqe. Në këto kushte, mirëkuptohet situata dhe nuk jemi para rrethanave të një kundërvajtje administrative.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Sarandë.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**